



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**  
**QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”**

**SHPALLJE KËRKESË PËR DONACION**

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullit, të cilit i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas ligjeve në fuqi, i cili ka në fokus të aktivitetit të tij mbrojtjen e jetës, shëndetit fizik dhe mendor të pacientit dhe lehtësimin e vuajtjeve të tij, duke i ofruar një shërbim shëndetësor sa më cilësor dhe dinjitoz.

Me anë të kësaj thirrje, QSUNT dëshiron të kërkojë vëmendjen e publikut lidhur me mundësinë për të kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe ofrimin e ndihmës në rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve të hospitalizuar në QSUNT.

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës spitalore dhe në vijim të nevojave të evidentuara nga Shërbimi i Kirurgjisë Kardiovaskulare, është identifikuar domosdoshmëria për realizimin e një ambienti të plumbuar (dhome hibride), i cili do të mundësojë në të ardhmen instalimin e pajisjeve me rreze X, në përputhje me standardet e sigurisë dhe mbrojtjes nga rrezatimi.

Ky investim synon të garantojë një infrastrukturë të përshtatshme dhe të qëndrueshme, duke shmangur ndërhyrje të mëvonshme dhe kosto shtesë, si dhe duke lehtësuar implementimin e teknologjive të avancuara mjekësore.

Në këtë kuadër, do të vlerësonim mbështetjen tuaj nëpërmjet një donacioni për realizimin e këtij ambienti.

**QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”**